



# **RAPORT VJETOR**

**2008**

## PARATHËNIE

Ky është raporti i parë vjetor i Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut (Paneli). Në pajtim me mandatin e Panelit, ky raport i vihet në dispozicion opinionit të gjerë publik.

Raporti mbulon aktivitetet e Panelit nga seanca e tij inaugurues në nëntor 2007 deri më 31 dhjetor 2008. Këtu do të përfshihen gjithashtu informacionet lidhur me ngjarjet që ndodhën para seancës inaugurues, si dhe miratimi i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 në mars 2006 mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, dhe emërimi i anëtarëve të parë të Panelit nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, (PSSP) më 12 janar 2007.

Në fund të konfliktit të Kosovës, Kombet e Bashkuara morën administrimin e Kosovës sipas Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të KB-së 1244 (Rezoluta) më 10 qershor të vitit 1999. Misioni i porsaformuar i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) u përball me një detyrë unike dhe sfiduese. Sipas Rezolutës, u vendos prani civile ndërkombëtare me përgjegjësi të përcaktuara primare, duke përfshirë edhe përgjegjësinë për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut. Mirëpo, vetë Rezoluta nuk përcaktoi mekanizma të qartë për të siguruar implementimin e mandatit të të drejtave të njeriut.

Krijimi i Panelit evoluoi nga diskutimet dhe kumtesat e shkruara, me të cilat kërkohet që të vendoset se si të sigurohet më së miri mbikëqyrja e standardeve të të drejtave të njeriut dhe të bëhet dëshmipërblimi efektiv për ankesat e të drejtave të njeriut. Në fazat e hershme të UNMIK-ut, anëtarët e interesuar të komunitetit të të drejtave të njeriut, ato vendore dhe ndërkombëtare, filluan të identifikojnë boshllëqet në këtë fushë. Në vitin 2000, u themelua Institucioni i Ombudspersonit në Kosovë me qëllim të avancimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut, por fushëveprimtaria e autoritetit të Ombudspersonit ishte e pamjaftueshme për të implementuar vargun e tërë të masave rregulluese të të drejtave të njeriut, të njohura ndërkombëtarisht.

Në shtator të vitit 2004, Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias) vuri në pah mungesën e “një mekanizmi adekuat dhe konsistent për shqyrtimin e pretendimeve për shkeljen e të drejtave të njeriut nga dy burimet “institucionale” me potencial për shkeljen e të drejtave të njeriut në Kosovë”<sup>1</sup> – UNMIK-u dhe 2 KFOR-i. Komisioni i Venecias propozoi që UNMIK-u të themelojë një gjykatë të pavarur të të drejtave të njeriut. Si një zgjidhje e përkohshme, Komisioni i Venecias rekomandoi formimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut.

Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës shprehu shqetësime të ngjashme lidhur me mekanizmat e të drejtave të njeriut që ishin në dispozicion atëherë në

<sup>1</sup> Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias), Opinioni për të Drejtat e Njeriut në Kosovë: Themelimi i mundshëm i mekanizmave të shqyrtimit, CDL-AD (2004)033, miratuar në sesionin e 60-të plenar të Komisionit (Venecia, 8-9 tetor 2004), në dispozicion në [http://www.venice.coe.int/docs/2004/CDL-AD\(2004\)033-e.asp](http://www.venice.coe.int/docs/2004/CDL-AD(2004)033-e.asp), § 74.

Kosovë, në janar 2005. Asambleja rekomandoi që UNMIK-u dhe KFOR/NATO të fillojnë punën, në bashkëpunim me Këshillin e Evropës, në themelimin e gjykatës për të drejtat e njeriut në Kosovë.<sup>2</sup>

UNMIK-u morri hapa për të transformuar Institucionin e Ombudspersonit në Kosovë në një organ tërësisht vendor, i cili nuk do të kishte juridiksion mbi pranimë civile ndërkombëtare kah fundi i vitit 2005. Pra, themelimi i Panelit synonte të plotësonte boshllëkun në përgjegjësinë për të drejtat e njeriut që rezultonte nga ky proces, dhe të trajtonte shqetësimet e ngritura nga Komisioni i Venecias, nga Këshilli i Evropës dhe nga palët tjera të interesuara.

Në analizën përfundimtare, Paneli ishte i përcaktuar të luaj një rol që ishte ndryshe nga ai që fillimisht ishte propozuar nga Komisioni i Venecias. Koncepti i ri ishte i bazuar në supozimin se Paneli, si një organ gjoja-gjyqësor, do të ishte një instrument i pavarur për rishqyrtimin e ankesave për pohime të shkeljeve të të drejtave të njeriut të kryera nga UNMIK-u. Në rastet ku Paneli në fakt konstaton se është bërë një shkelje e të drejtave të njeriut, do t'i bëjë rekomandime publike PSSP-së për masat që duhet ndërmarrë për rregullimin e shkeljeve.

Paneli përfundimisht u bë operacional në nëntor të vitit 2007. Që nga ajo kohë, është bërë e qartë se Paneli ka të luaj një rol të rëndësishëm në relacion me vazhdimin e pranisë civile ndërkombëtare në Kosovë. Themelimi i Panelit ishte një hap i rëndësishëm në sigurimin e një niveli adekuat të mbrojtjes dhe përgjegjësisë për të drejtat e njeriut në Kosovë. Ky konkludim është dëshmuar nga lloji i ankesave dhe rritja e shpejtë e numrit të rasteve të cilat janë dorëzuar në këtë Panel. Çështjet që shqyrtohen nga Paneli janë çështje të rëndësishme konkrete të të drejtave të njeriut që janë paraqitur në kontekstin e Kosovës që nga 1999.

Marek Nowicki

Kryetar

Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut

31 janar 2009

---

<sup>2</sup> Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, Rezoluta 1417 (2005) mbi mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë, miratuar më 25 janar 2005, në dispozicion në <http://assembly.coe.int/Mainf.asp?link=/Documents/AdoptedText/ta05/ERES1417.htm>.

## 1. HYRJE

1. Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut (Paneli) u themelua në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/12 të datës 23 mars 2006 mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut (Rregullorja)<sup>3</sup> me mandat për të shqyrtuar ankesat nga individët ose grupet e individëve të cilët pohojnë se janë viktimat të shkeljes së të drejtave të njeriut nga UNMIK-u.

Paneli u themelua për t'ju përgjigjur ftesave për themelimin e një mekanizmi që do të shqyrtonte përputhshmërinë e UNMIK-ut me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, në rolin e tij si administratë e përkohshme tranzicionale në Kosovë. Është tërësisht i pavarur dhe organizimi dhe mandati i tij janë të tillë sa që më së miri mund të kualifikohet si organ gjoja gjyqësor.

Paneli është mekanizmi i parë për ankesa të të drejtave të njeriut i llojit të vet në misionet paqeruajtëse të Kombeve të Bashkuara (KB) që ushtron kompetenca tranzicionale administrative. Si i tillë, konfrontohet me çështje të caktuara unike, duke përfshirë edhe përkufizimin e sferës së veprimit apo mosveprimit të cilat i atribuohen UNMIK-ut, duke vlerësuar shterimin e mjeteve që ankuesi i ka pasur në dispozicion në kontekstin e përgjithshëm të imunitetit të KB-së nga procedurat ligjore, dhe karakterizimin e shkeljeve që vazhdojnë apo nuk vazhdojnë në kontekstin e juridiksionit të përkohshëm të kufizuar të Panelit.

2. Edhe pse Paneli u themelua me Rregulloren e marsit të vitit 2006, kaloi shumë kohë derisa u bë funksional. Anëtarët e parë u emëruan nga PSSP-ja më 12 janar të vitit 2007 dhe ata u thirrën për mbledhjen inauguruese në tetor të vitit 2007. Mirëpo, kjo u shty për arsye administrative dhe Paneli përfundimisht filloi punën e vet në nëntor të vitit 2007.

Paneli, me mbështetjen e UNMIK-ut, i krijoi lokalet e veta dhe rekrutoi stafin gjatë vitit të parë të plotë të punës së vet. Ky Panel drejtoi një fushatë publike informative dhe krijoi uebsajtin, që të dyja këto u konsideruan si esenciale për funksionimin e duhur të Panelit, si organ kompetent për pranimin e ankesave nga populli. Themeloi sistemin elektronik të menaxhimit të rasteve dhe krijoi edhe objektet për punë hulumtuese elektronike dhe në bibliotekë. Paneli shpalli Rregulloren e vet të Punës, dhe bëri priorizimin e rasteve për t'u vlerësuar nëse janë të pranueshme dhe për t'ju komunikuar më pastaj PSSP-së.

3. Paneli mbajti dymbëdhjetë (12) sesione, pranoi tetëdhjetë e katër (84) ankesa, administroi tridhjetë (30) ankesa, katërmëdhjetë (14) ankesa konstatoi se janë të pranueshme, shtatëmbëdhjetë (17) ankesa të papranueshme, dhe miratoi mendimin për bazueshmërinë e një (1) rasti që nga sesioni inaugurues në nëntor, 2007 deri në dhjetor 2008.

Ankesat e dorëzuara Panelit kanë shqetësime për një varg të gjerë të pohimeve për shkelje të të drejtave të njeriut, duke përfshirë edhe të drejtën për jetë, ndalimin e keqtrajtimit, të drejtën për gjykim të drejtë, të drejtën për t'u respektuar jeta private dhe ajo familjare, të drejtën në mjet efektiv dhe të drejtën për zotërim të pronës.

<sup>3</sup> Rregullorja i është bashkëngjitur këtij raporti (shtojca 1).

## 2. PËRBËRJA E PANELIT

### 2.1 Anëtarët e Panelit

Tri anëtarët e Panelit me gjysmë orari, të caktuar nga Kryetari i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të emëruar nga PSSP-ja, në pajtim me Rregulloren e 12 janarit 2007, ishin si vijon:

Z. Paul Lemmens (Belgjikë), gjyqtar në Këshillin shtetëror belg dhe profesor i drejtësisë për të drejtat e njeriut në Universitetin e Leuven;

Z. Marek Nowicki (Poloni), Kryetar i Fondacionit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, Varshavë, dhe ish Ombudsperson në Kosovë;

Znj. Michèle Picard (Francë), Zëvendëskryetare e Gjykatës së shkallës së parë në Paris dhe ish Kryetare e Dhomës për të drejtat e njeriut për Bosnje dhe Hercegovinë.

Paneli zgjodhi z. Marek Nowicki Kryetar të Panelit në janar 2008.

Znj. Picard dha dorëheqje nga Paneli më 3 mars 2008, pasi u emërua si gjyqtare (*ad litem*) për me zëvendësuar një tjetër në Tribunalin Ndërkombëtar Penal për ish Jugosllavi në Hagë.

Znj. Snezhana Botusharova (Bullgari), ish gjyqtare në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Strasbourg, u emërua nga Kryetari i Gjykatës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut dhe u caktua në Panel nga PSSP-ja për të zëvendësuar znj. Picard, më 6 maj 2008.

Është kërkesë fundamentale që anëtarët e Panelit të kenë karakter të lartë moral, paanshmëri dhe ndershmëri me ekspertizë të demonstruar në të drejtat e njeriut. Shënimet biografike të anëtarëve të Panelit janë dhënë më poshtë:

4. **Marek A. Nowicki** (janar 2007-vazhdon), është qytetar polak dhe avokat për të drejtat e njeriut. Z. Nowicki ishte i emëruar nga KB-ja si Ombudsperson Ndërkombëtar në Kosovë nga korriku 2000 deri në dhjetor 2005. Ishte anëtar i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në Strasbourg nga marsi 1993 deri më 31 tetor 1999, dhe ishte anëtar polak i Rrjetit të Ekspertëve të Pavarur të Bashkimit Evropian për të Drejtat Fundamentale, nga marsi 2003 deri në shtator 2006.

Nga viti 1982 e tutje, gjatë kohës së administrimit ushtarak në Poloni, z. Nowicki ishte kolumnist për shtypin e fshehtë, disident në lëvizjen e “Solidaritëtit” në Poloni. Në të njëjtën kohë, ishte bashkëthemelues, aktivist i Komitetit të Helsinkit në Poloni dhe bashkautor i të gjitha raporteve të tij për situatën e të drejtave të njeriut në Poloni.

Ai ishte themelues i Fondacionit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Varshavë dhe kryetar i tij nga nëntori 2003 deri më shkurt 2008. Ai është anëtar i Këshillit Këshillimor të Qendrës Ndërkombëtare për Mbrojtjen Ligjore të të Drejtave të Njeriut në Londër (INTERIGHTS). Z. Nowicki është autor i dhjetëra librave dhe qindra

artikujve për të drejtat e njeriut, të botuara në Poloni dhe jashtë. Ai gjithashtu ligjëron për të drejtat e njeriut në “Collegium Civitas” Universiteti i Varshavës.

5. **Paul Lemmens** (janar 2007-vazhdon), qytetar belg, është anëtar i avokatisë në Bruksel dhe ka qenë gjyqtar në Këshillin shtetëror të Belgjikës që nga viti 1994. Ai ishte anëtar i atij sektori të Këshillit shtetëror që shqyrton kompatibilitetin e draft legjislacionit dhe draftregulloreve me normat më të larta të ligjeve vendore dhe ndërkombëtare për dhjetë vite tani. Ai aktualisht shërben në gjykatën supreme administrative, që është pjesa kontestimore e Këshillit.

Z. Lemmens gjithashtu ka qenë profesor me gjysmë orari në Universitetin Leuven që nga viti 1986, ku ai ka ligjëruar për ligjin ndërkombëtar mbi të drejtat e njeriut. Ai ka ligjëruar edhe të drejtën kushtetuese, procedurën civile dhe procedurën administrative. Ai është autor i një sërë librash dhe artikujsh për ligjin evropian mbi të drejtat e njeriut. Është drejtor belg i programit evropian për master mbi të drejtat e njeriut dhe demokratizimin, një program evropian ndëruniversitar, që ndodhet në Venecie, (Itali).

Z. Lemmens ishte anëtar i Komisionit belg për mbrojtjen e të dhënave që nga viti 1987 deri më 1997, dhe ai ka shërbyer si anëtar i Komisionit shtetëror për të drejtat e fëmijës nga viti 2007. Ai ishte ekspert i Këshillit të Evropës për studimin e kompatibilitetit të sistemeve të caktuara kombëtare (shtetet e Evropës qendrore dhe lindore) me Konventën Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut gjatë vitit 1990. Aktualisht, ai është ekspert i lartë për Belgjikën në grupin e ekspertëve ligjor të Agjencisë së Bashkimit Evropian mbi të drejtat fundamentale (FRALEX).

6. **Michèle Picard** (janar 2007-mars 2008), qytetare frënge, u emërua gjyqtare në vitin 1982. Ajo më vonë u bë Zëvendëskryetare e *Tribunal de Grande Instance* të Parisit. Në mars të vitit 1996 ajo u emërua nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës anëtare e Dhomës për të drejtat e njeriut në Bosnje dhe Hercegovinë. Ajo ishte kryetare e Dhomës nga nëntori i vitit 1997 deri më dhjetor 2003.

Znj. Picard ishte anëtare alternative e nën-komisionit të KB-së mbi promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut deri më 2006, e cila nga Kryetari i Komisionit të KB-së për të Drejtat e Njeriut për dy vite në korrik 2005 u caktua si eksperte e pavarur për situatën e të drejtave të njeriut në Uzbekistan. Ajo u zgjodh nga Asambleja e Përgjithshme e KB-së gjyqtare *ad litem* në Tribunalin Ndërkombëtar Penal për ish Jugosllavi, më 24 gusht 2005, një funksion që ajo e morri më 3 mars 2008. Znj. Picard gjithashtu punoi në sektorin e të drejtave të njeriut në Këshillin e Evropës në Shqipëri, në IRJM dhe në Bosnje dhe Hercegovinë

7. **Snezhana Botusharova** (maj 2008-vazhdon), qytetare bullgare, ishte gjyqtare në Gjykatën Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut nga 1 nëntor 1998 deri më 30 prill 2008, dhe gjithashtu zëvendëskryetare e seksionit të pestë të gjykatës. Aktualisht, ajo është gjyqtare ndërkombëtare në Gjykatën e Bosnjës dhe Hercegovinës. Ajo gjithashtu ka shërbyer ambasadore e Republikës së Bullgarisë, me kompetenca të jashtëzakonshme dhe fuqiplota në Shtetet e Bashkuara të Amerikës nga 1994 deri më 1998.

Znj. Botusharova ishte anëtare e Asamblesë Kombëtare Bullgare në emër të Unionit të Forcave Demokratike dhe ishte njëra nga autoret e Kushtetutës së re të Bullgarisë. Ajo është rizgjedhur për Asamblenë e 36-të Kombëtare dhe ishte Zëvendëskryesuese e kësaj Asambleje dhe ushtruese e detyrës së kryesuesit, nga shtatori deri në nëntor të vitit 1992. Si deputete e Parlamentit ajo morri pjesë në aktivitete të ndryshme

legjislative në përgatitjen e bazës ligjore për tranzicionin e Bullgarisë në shtet demokratik dhe sundim të së drejtës. Ajo gjithashtu ishte anëtare e Komisionit Evropian për demokraci përmes ligjit e Këshillit të Evropës nga viti 1991 deri në vitin 1994 dhe, në këtë cilësi, përgatit opinione ligjore për draft-kushtetutat e Ukrainës, Federatës Ruse dhe Moldavisë.

Znj. Botuscharova morri gradën e doktorit të shkencave juridike nga Universiteti Lomonosov i Moskës. Ajo punoi si avokate në avokatinë e Sofjes, para se të bëhej profesoreshë e të drejtës kushtetuese në Kliment Ohridski Universiteti i Sofjes, në Universitetin e ri të Bullgarisë në Sofje dhe në Universitetin Neofit Rilski në Blagoevgrad. Ajo është autore e librave dhe artikujve mbi të drejtën kushtetuese, veçanërisht e Kushtetutës së re të Bullgarisë, dhe për çështje të të drejtave të njeriut.

## 2.2 Sekretariati i Panelit

8. Sekretariati i Panelit përbëhet prej zyrtarit ekzekutiv, zyrtarit ligjor dhe dy zyrtarëve administrativ. Një zyrtar për të drejtat e njeriut dhe një zyrtar ligjor shtesë janë në proces të rekrutimit. Shënimet biografike të personelit të Sekretariatit janë dhënë më poshtë:

**John J. Ryan**, qytetar irlandez, fillimisht u punësua si avokat ndihmës me Stephen MacKenzie dhe me bashkë-avokatët, nga Dublin, Irlandë. Ai u caktua si zyrtar ekzekutiv i Sekretariatit të Panelit nga PSSP-ja, në shtator të vitit 2007. Para se të merr përgjegjësitë aktuale ai u punësua si shef i Divizionit ndërkombëtar për mbështetje të gjyqësorit, Departamenti i Drejtësisë, UNMIK dhe më pastaj si zyrtar i lartë ligjor, Z/PSSP, UNMIK. Z. Ryan është i diplomuar në Universitetin Limerick, Irlandë, në fushën e drejtësisë, (Hons) në drejtësi dhe studime evropiane, dhe ka diplomuar në Fakultetin e Drejtësisë në shoqërinë e inkuorporuar të drejtësisë në Irlandë.

**Leanne Ho**, qytetare australiane, u caktua si zyrtare ligjor në Panel, në dhjetor, 2007. Ajo filloi punën në KB si zyrtare ligjore në Departamentin Drejtësisë së UNMIK-ut në vitin 2003 ku ajo ishte e punësuar, mes tjerash, si menaxhere e operacioneve në sektorin e integritit gjyqësor, si këshilltare ligjore ndërkombëtare në Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe si zyrtare ligjore në Divizionin Ndërkombëtar për mbështetje gjyqësorit. Ajo u ricaktua në Misionin e Kombeve të Bashkuara në Liberi, në shtator, 2008.

**Martin Clutterbuck**, qytetar australian, ishte zyrtar ligjor në Panel nga shtatori deri në dhjetor 2008 kur ai e pranoi postin e shefit të zyrës në Komisionin e Ankesave Pronësore të Kosovës. Ai paraprakisht punoi për UNMIK-un në cilësi të ndryshme sikurse koordinator ndërkombëtar për ndihmë juridike në Departamentin e Drejtësisë dhe kryetar i Komisionit për regjistrimin e ankesave. Ai punoi me UNTAET/UNMISSET në Timorin Lindor si zyrtar ligjor për zëvendësprokurorin special për krime të rënda nga viti 2001 deri 2003. Para kësaj, ai punoi në Australi si ndihmës-avokat kryesor/koordinator në një sërë të qendrave të komunitetit ligjor, si dhe si konsulent me Organizatën Botërore për Zhvillim e Ligjit. Z. Clutterbuck u kualifikua për avokat në Australi në vitin 1995.

**Bernadette Foley**, qytetare amerikane, është zyrtare ligjor, e cila erdhi në Panel në dhjetor të vitit 2008. Ajo paraprakisht ishte punësuar si inspektore e lartë në Këshillin Disiplinor të zyrës së UNMIK-ut, e cila zyrë hetonte pohimet për keqsjellje etike të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Nga viti 2005 deri më 2006 ajo menaxhoi, dizajnoi dhe

ofroi një program trajnimi për hetuesit që merren me keqsjellje gjyqësore dhe prokuroriale në një projekt të përbashkët të UNDP/UNMIK. Nga viti 2002-2004 ajo ishte anëtare vizitore në fakultetin e drejtësisë në Universitetin e Rosisë, nën projektin e edukatës qytetare të institutit për shoqëri të hapur. Prej vitit 1986 deri më 2001, ajo ishte avokate e gjykimeve dhe apeli në Shtetet e Bashkuara, në fushën e të drejtës penale dhe asaj të shëndetit mental.

**Snezana Martinović**, me kombësi serbe, ka qenë punëtore administrative në Panel që nga dhjetori 2007. Ajo filloi të punojë në UNMIK në vitin 2000 ku punoi si punëtore administrative në Departamentin e Drejtësisë.

**Ruzvelt Frrokaj**, shqiptar i Kosovës, ka qenë punëtor administrativ në Panel nga nëntori i vitit 2007 deri në përfundimin e detyrës së tij në UNMIK në qershor të vitit 2008. Ai filloi të punojë në UNMIK në mars të vitit 2000 ku u punësua si zyrtar i sigurimit dhe punëtor administrativ në Administratën e UNMIK-ut, dhe gjithashtu si punëtor administrativ në zyrën e ndërmarrjeve në pronësi publike, Z/PSSP.

**Mimoza Arifi-Hoxha**, shqiptare e Kosovës, ka qenë punëtore administrative në këtë Panel që nga nëntori 2008. Ajo filloi punën në UNMIK në dhjetor të vitit 1999 si punëtore administrative në Divizionin e Informimit Publik/Zyra e shtypit.

9. **Magda Mierzewska**, qytetare polake, ishte dërguar në mision të përkohshëm në këtë Panel nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Strasbourg, për një periudhë dymujore nga maji deri më korrik 2008. Znj. Mierzewska është avokate në zyrën e regjistrimit të gjykatës, e cila ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në Panel për sa i përket kërkimit, analizave dhe hartimit gjatë misionit të saj të përkohshëm.

### 3. KORNIZA LEGJISLATIVE DHE PROCEDURALE

#### 3.1. Korniza legjislative

10. Në pajtim me Rregulloren, Paneli mund të shqyrtojë ankesa sipas një vargu të tërë të instrumenteve mbi të drejtat e njeriut, në veçanti Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut, Konventës Ndërkombëtare mbi të Drejta Civile dhe Politike, Konventës Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Konventës mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor, Konventës mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve ose Dënimeve tjera Mizore, Johumane dhe Degraduese dhe Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës.

Në praktikë, ankuesit i bazojnë ankesat e tyre kryesisht në nenet e Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe Protokollet e saj.

#### 3.2. Korniza procedurale

11. Me Rregulloren janë caktuar disa aspekte procedurale të cilat duhet të përcillen nga Paneli dhe palët. Ata parashohin procedurë adversiale në dy hapa: së pari, shqyrtimi i pranueshmërisë së ankesës, pastaj, nëse ankesa shpallet e pranueshme, shqyrtimi i bazueshmërisë së ankesës. Procedura mund të na shpie në një opinion, i cili i dërgohet PSSP-së dhe mund të përfshijë edhe rekomandime.

Në pajtim me Rregulloren, Paneli miratoi Rregulloren e Punës, më 5 shkurt 2008. Këto rregulla, të cilat janë të bazuara në rregullat e Gjykatës Evropiane të të Drejtave



të Njeriut, përmbajnë dispozita të detajuara për trajtimin e ankesave dhe procesin e diskutimeve në Panel.<sup>4</sup>

Bazuar në praktikën e ndjekur nga Paneli gjatë periudhës së shqyrtimeve, më poshtë është dhënë një përshkrim i shkurtër i hapave kryesor në këtë procedurë:

12. Sa i përket dorëzimit të ankesave, rekomandohet që ankesat të kenë formën standarde në dispozicion nga Sekretariati i Panelit, apo nga uebsajti i tij, në shqip, serbisht, (latinicë ose qirilicë) ose anglisht. Për ankuesit të cilët nuk e kanë përdorur formën standarde, Sekretariati do të kërkojë, sipas rregullit, që ata të plotësojnë formën e aplikacionit.

Nuk ka pagesë për dorëzimin e ankesës në Panel dhe nuk kërkohet përfaqësim ligjor, edhe pse shumë ankues janë të përfaqësuar ligjërisht. Gjatë plotësimit të formës së aplikacionit, ankuesit duhet të paraqesin të gjitha faktet relevante në të cilat bazohet shkelja e pohuar e të drejtave të njeriut. Dëshmi dokumentare dhe materiale mbështetëse mund t' i bashkëngjiten ankesës. Paneli, në fakt, i inkurajon ankuesit që të dorëzojnë një kopje të tërë dosjes së bashku me ankesën.

Paneli mund të kërkojë informacione shtesë nga ankuesi ose nga PSSP-ja, dhe nga PSSP-ja mund të kërkojë sjelljen e ndonjë personi ose përgatitjen e ndonjë dokumenti që është relevant për ankesën. Ashtu siç parashihet me Rregullore, PSSP-ja do të bashkëpunojë me Panelin dhe do t' i sigurojë ndihmën e nevojshme në ushtrimin e kompetencave dhe autoritetit të vet, duke përfshirë, në veçanti, përmes lëshimit të dokumenteve dhe informacioneve relevante për ankesën. PSSP-ja tash së voni kërkoi nga Paneli që të kërkojë informacione dhe dokumente drejtpërsëdrejti nga agjencitë përkatëse. Tani Paneli e ka miratuar këtë praktikë si procedurë standarde.

13. Pas marrjes së ankesës, Paneli së pari duhet të konstatojë nëse është kompetent të trajtojë ankesën dhe nëse ankesa është e pranueshme. Paneli është i autorizuar të trajtojë vetëm ato ankesa që kanë të bëjnë me veprimin ose mosveprimin për të cilin përgjegjës është UNMIK-u, dhe vetëm për pohimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut të cilat janë bërë jo më herët se 23 prill 2005, apo që dalin nga faktet që janë paraqitur para kësaj date, dhe ku këto fakte tregojnë një shkelje të vazhdueshme të të drejtave të njeriut.

Ankesat mund të paraqiten nëse janë ndjekur të gjitha mjetet tjera në dispozicion dhe rrugët për shqyrtimin e shkeljes së pohuar, dhe me kusht që ankesa të jetë paraqitur brenda gjashtë muajsh nga data kur është marrë vendimi i formës së prerë. Ankesat të cilat janë jokompatibile me standardet e të drejtave të njeriut, d.m.th. ankesat të cilat paraqesin një shkelje të një të drejte që nuk është e garantuar me asnjërin nga instrumentet e të drejtave të njeriut në kuadër të juridiksionit të Panelit, janë të papranueshme. Përfundimisht, Rregullorja e lejon Panelin të refuzojë një ankesë, në fazën e pranueshmërisë, nga arsyeja se shihet qartazi se është e pabazuar.

14. Paneli mund ta deklarojë një ankesë si të papranueshme menjëherë, pas një analize të ankesës. Nëse Paneli në këtë fazë nuk mund të arrijë konkludim në bazë të vet ankesës, për këtë ankesë e njofton PSSP-në për të marrë komentet e tij për ankesën. Nëse PSSP-ja njoftohet me një ankesë të tillë, Paneli në mënyrë rutine e fton PSSP-në që të jep komentet e tij edhe për pranueshmërinë e ankesës edhe për

<sup>4</sup> Rregullorja e Punës i është bashkëngjitur këtij raporti (shtojca 2).

bazueshmërinë e saj. Paneli mund t' ia sigurojë përgjigjen e PSSP-së ankuesit që të jep komentet e tij.

Edhe pse Paneli menjëherë mund të miratojë një opinion për bazueshmërinë e ankesës, duke përfshirë edhe vendimin e tij për pranueshmërinë e saj, deri tani ka miratuar vendim të veçantë për pranueshmërinë e ankesës. Të gjitha vendimet e Panelit për pranueshmërinë e ankesës janë shpallur në uebsajtin e Panelit.

15. Pasi që ankesa të jetë deklaruar e pranueshme, procedura hyn në fazën e shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës. Në rastin *Canhasi*, PSSP-ja ngriti çështjen e pranueshmërisë, d.m.th. mosshkrimin e mjeteve, pas vendimit të Panelit me të cilin ankesën e deklaroi të pranueshme. Paneli theksoi se palët natyrisht se do të ndalohen që kundërshtimet e tyre për pranueshmërinë t' i paraqesin me vonesë. Mirëpo, u vendos se nuk është e nevojshme të merret qëndrim për pranueshmërinë e kundërshtimeve të palës së paditur në këtë rast, meqë kundërshtimi, edhe ashtu, ishte i pabazuar (*Canhasi*, 04/08).

Nga palët mund të kërkohet që të ofrojnë informacione të tjera, por edhe atyre u jepet mundësia që të japin komentet e tyre për bazueshmërinë e ankesës. Nëse është në interesin e drejtësisë, mund të mbahen dëgjime publike. Praktika e Panelit ka qenë, deri tani, që të organizojë dëgjime publike vetëm kur vlera e tyre e shtuar është e qartë, dhe deri tani nuk janë mbajtur dëgjime të tilla.

Në arritjen e opinionit për bazueshmërinë e ankesës, Paneli ankesën e shqyrton në frymën e dispozitave të të drejtave të njeriut në të cilat thirret ankuesi apo të cilat janë relevante për çështjet në atë rast. Paneli konstaton nëse është bërë apo jo shkelje e të drejtave të njeriut nga UNMIK-u. Në rastin e konstatimit të një shkelje, Paneli mund t' i bëjë rekomandime UNMIK-ut për masat që duhet ndërmarrë. Opinione të Panelit gjithashtu shpallen në uebsajt.

Është e drejtë e posaçme e PSSP-së që t' i përgjigjet opinionit të Panelit, dhe përgjigjja e PSSP-së për rekomandimet gjithashtu shpallet në uebsajtin e Panelit.

#### **4. INICIATIVAT PËR INFORMIM PUBLIK**

16. Paneli ka drejtuar një fushatë për vetëdijesimin publik dhe u angazhua në dialog me organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare gjatë vitit 2008, në mënyrë që të informojë opinionin e gjerë për ekzistimin dhe mandatin e Panelit, si një mekanizëm për ankesat e të drejtave të njeriut. Kjo fushatë përfshinte takime publike, intervista me mediat, komunikata për shtyp, takime me organizata joqeveritare, (OJQ-të) dhe me organizata ndërkombëtare, veçanërisht me ato të përfshira në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë.

Paneli dhe Sekretariati gjithashtu mbajtën një takim të hershëm më 13 mars 2008 me përfaqësuesit e OJQ-ve, me shoqërinë civile, me zyrat e ndihmës juridike dhe me komunitetet e pakicave, të cilët aktivisht janë të angazhuar në sektorin e të drejtave të njeriut në Kosovë. Paneli dhe Sekretariati ofruan një prezantim të shkurtër gojor për pjesëmarrësit me këtë rast, që pasoi me një seancë të pyetjeve dhe përgjigjeve.

Paneli më tutje është angazhuar në paraqitjet në media, duke përfshirë intervistat në radio dhe TV, në vise të ndryshme minoritare, për të theksuar punën e Panelit. Një

transmetim i njoftimit të shërbimeve publike mbi operacionet e Panelit është dhënë në TV-të e Kosovës dhe Serbisë më 2 qershor 2008.

Sekretariati i Panelit gjithashtu drejtoi një fushatë të informimit publik në rajon. Dizajnoi dhe përpiloi broshura informative në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze, të cilat janë shpërndarë gjerësisht nëpër gjykata, në objektet komunale dhe qeveritare, dhe nëpër organizatat joqeveritare (OJQ-të) si dhe në zyrat e ndihmës juridike dhe zyrat ndërlidhëse të gjykatave.

Në shtator të vitit 2008, Sekretariati i paraqiti Panelit të Komisionit të Kosovës për Ndihmë Juridike informacione për mandatin dhe operacionet e Panelit. Kjo pasoi në tetor të vitit 2008 me një takim me përfaqësues të Programit të Ndihmës Juridike të Institucioneve të Qeverisë së Serbisë, të cilët merren me refugjatët dhe personat e zhvendosur brenda vendit në Serbi. Ky program është i financuar dhe i implementuar nga Këshilli danez për refugjatët.

Sekretariati i Panelit vazhdoi me fushatën e informimit publik gjatë një vizite në Serbi, më 26 dhe 27 nëntor 2008, ku u takua me Asociacionin e personave të kidnapuar dhe të vrarë në Prokuplje dhe me z. Gianfranco D'Eramo, shef i Këshillit danez për refugjatët në Beograd, më 26 nëntor. Sekretariati gjithashtu u takua me përfaqësues të Ministrisë për Kosovë dhe Metohi, me UNHCR-në, me Këshillin danez për refugjatët, me Organizatën ndërkombëtare për migrim, me PRAXIS, me Iniciativën për zhvillim dhe bashkëpunim dhe me Qendrën e Ballkanit për Migrim dhe aktivitete humanitare, dhe fushatën e përmbylli me një takim të mbajtur me znj. Krana Petkovic, Ndihmësministër, Ministria për Kosovë dhe Metohi, më 27 nëntor.

## 5. NGARKESA E PANELIT ME RASTE

17. Një numër i përgjithshëm prej tetëdhjetë e katër (84) ankesave janë dorëzuar në Panel gjatë periudhës raportuese, duke përfshirë edhe pesëmbëdhjetë (15) ankesat të cilat u dorëzuan në vitin 2006 dhe 2007, para seancës së inaugurimit të Panelit në nëntor të vitit 2007. Në të vërtetë, pesëmbëdhjetë (15) ankesat e para u dorëzuan gjatë shpalljes së Rregullores, më 23 mars 2006.

Paneli miratoi tridhjetë (30) vendime në vitin 2008 duke filluar me vendimin e parë mbi pranueshmërinë e ankesës më 6 shkurt 2008. Shtatëmbëdhjetë (17) prej këtyre vendimeve i shpallën ankesat tërësisht të papranueshme, dy (2) ankesa u shpallën pjesërisht të papranueshme. Paneli e ka shtyrë shqyrtimin e mëtejshëm të këtyre dy (2) ankesave dhe dhjetë (10) ankesat tjera u shpallën plotësisht të papranueshme.

Më 12 nëntor 2008 Paneli miratoi opinionin e tij të parë, në të cilin gjeti shkelje të aspektit procedural të së drejtës për jetë, sepse mungonte një hetimi efektiv për vrasjen e gruas së ankuesit, *Shaip Canhasi*. Me këtë opinion është njoftuar PSSP-ja më 21 nëntor, 2008 dhe ai nuk pati kohë të njaftueshme për t'ju përgjigjur rekomandimeve të Panelit para përfundimit të periudhës së raportimit.

Ka pasur gjashtëdhjetë e nëntë (69) raste që janë në pritje pranë Panelit më 31 dhjetor 2008. Nga këto raste, pesëdhjetë e katër (54) ishin akoma në fazën e përcaktimit të pranueshmërisë, derisa katërmëdhjetë (14) raste ishin në fazën e caktimit të bazueshmërisë.

18. Në ankesat e paraqitura pranë Panelit janë paraqitur tendenca të caktuara. Siç u tha, në shumicën e ankesave paraqiten shkelje të Konventës Evropiane mbi të Drejtat

e Njeriut, (KEDNJ) ose të Protokolleve të saj. Dispozitat e KEDNJ të cilat përbëjnë numrin më të lartë të shkeljeve gjatë periudhë së raportimit ishin:

Neni 1 i Protokollit nr. 1 i KEDNJ lidhur me të drejtën për mbrojtje të pronës;

Neni 6, KEDNJ lidhur me të drejtën për gjykim të drejtë brenda një periudhe të arsyeshme dhe

Neni 13, KEDNJ lidhur me të drejtën për një mjet efektiv.

Çështjet kontestuese në ankesat drejtuar Panelit përfshinin:

- Pohime të shkeljes së të drejtës për jetë (neni 2 KEDNJ), lidhur me gjoja hetimin joadekuat të fatit të personit të zhdukur.
- Pohime të shkeljeve të së drejtës për jetë (neni 2 KEDNJ), lidhur me gjoja hetimin joadekuat të vrasjes.
- Pohime për shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë brenda një kohe të arsyeshme (neni 6 § 1 KEDNJ) dhe e drejta për mjet efektiv (neni 13 KEDNJ), lidhur me kërkesën për kompensim të pronës në pritje në gjykatat komunale në Kosovë që nga viti 2004.
- Pohime për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë (neni 6 § 1 KEDNJ), e drejta për të respektuar jetën private dhe atë familjare (neni 8 § 1 KEDNJ) dhe e drejta për mbrojtjen e pronës (neni 1 i Protokollit nr. 1) si dhe e drejta për mjet efektiv (neni 13 KEDNJ, lidhur me vendimet e marra nga Drejtoria për Çështje Banesore Pronësore dhe Komisioni i saj i Ankesave për Çështje Banesore Pronësore, dhe Agjencia Kosovare e Pronës dhe Komisioni i saj i Ankesave Pronësore, lidhur me pronësinë dhe zotërimin.
- Pohime të shkeljes të së drejtës për gjykim të drejtë (neni 6 § 1 KEDNJ), e drejta për të respektuar jetën private dhe familjare (neni 8 § 1 KEDNJ) dhe e drejta për mbrojtje të pronës (neni 1 i Protokollit nr. 1) si dhe e drejta për mjet efektiv (neni 13 i KEDNJ), në lidhje me dëbimin e pasuksesshëm të uzurpuesve të paligjshëm të pronës.
- Pohime për shkelje të së drejtës në gjykim të drejtë (neni 6 § 1 KEDNJ), e drejta për të respektuar jetën private dhe familjare (neni 8 § 1 KEDNJ) dhe e drejta për mbrojtje të pasurisë (neni 1 i Protokollit nr. 1) si dhe e drejta në mjet efektiv (neni 13 i KEDNJ, lidhur me vendimet kontradiktore për rastet e pronave në mes të Drejtorisë për Çështje Banesore Pronësore apo Agjencisë Kosovare të Pronës dhe gjykatave komunale dhe të qarkut.
- Pohimet për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë (neni 6 § 1 KEDNJ) dhe e drejta për mbrojtje të pronës (neni 1 i Protokollit nr. 1), në lidhje me vendimet e marra nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, përkritazi me përfitimet e punëtorëve që duhet paguar përmes procesit të privatizimit të ndërmarrjeve në pronësi shoqërore.

- Pohimet për shkelje të së drejtës për mbrojtje të pronës (neni 1 i Protokollit nr. 1), në lidhje me konfiskimin e pasurisë nga autoritetet për zbatimin e ligjit.

Dy ankesave, në veçanti, u është kushtuar vëmendje e konsiderueshme publike:

- Rasti i parë ka të bëjë me një ankesë lidhur me pohimet për helmimin me plumb dhe shkeljeve të tjera të të drejtave të një numri të madh të pjesëtarëve të komunitetit rom, të cilët jetojnë në kampe për njerëzit e zhvendosur brenda vendit në veriun e Kosovës (*Mehmeti dhe të tjerët., 26/08*).
- Ankesa tjetër ka të bëjë me pohimet për përdorimin e paautorizuar dhe disproporcional të forcës nga policia UNMIK-ut në shpërndarjen e një demonstrate në rrugë, në shkurt të vitit 2006, që rezultoi me vdekjen e dy individëve dhe me lëndime të ankuesve të tjerë (*Balaj dhe të tjerët., 04/07*).

Ankesat më të shumta të pranuar nga Paneli për të Drejtat e Njeriut kanë të bëjnë me çështje pronësore. Në këtë aspekt, Paneli ka pranuar ankesa që lidhen me agjencitë vijuese të UNMIK-ut nga e para tek e fundit:

Agjencia Kosovare e Pronës (AKP);  
Drejtoria për Çështje Banesore Pronësore (DÇBP);  
Komisioni i Ankesave për Çështje Banesore Pronësore (KAÇBP)  
Gjykatat komunale të komunave të ndryshme;  
Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje lidhur me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit; UNMIK-u dhe PSSP-ja përgjithësisht dhe Policia e UNMIK-ut.

## 6. PRAKTIKA GJYQËSORE E PANELIT

19. Paneli filloi zhvillimin e praktikës së vet gjyqësore gjatë kohës së përpunimit të ankesave individuale të shkeljeve të pohuara të të drejtave të njeriut që ishin paraqitur pranë tij. Duke ditur faktin se Paneli filloi punën e vet relativisht vonë, praktika e tij gjyqësore u përqendrua, në fund të vitit 2008, në pranueshmërinë dhe në çështjet e pragut, duke përfshirë edhe parametrat themelorë të praktikës së tij gjyqësore. Praktika gjyqësore e Panelit nuk është kufizuar në çështje të pranueshmërisë së ankesave meqë ai ka administruar një sërë çështjesh esenciale. Më poshtë është paraqitur një pasqyrë e vendimeve kryesore të Panelit.

### 6.1. Çështjet e pranueshmërisë së ankesave

20. Paneli ka shqyrtuar një numër të caktuar të çështjeve të pranueshmërisë së ankesave gjatë periudhës së raportimit dhe disa prej tyre janë përvijuar më poshtë:

#### 6.1.1 *Pranueshmëria racione temporis*

21. Në rastin *Behrami* Paneli konstatoi se ankesa ishte e papranueshme *racione temporis* meqë ngjarjet për të cilat ankohej, që rezultuan me vdekjen e një fëmije të moshës 12 vjeçare dhe lëndime të rënda të një fëmije tjetër të moshës 10 vjeçare, përmes zbrazjes aksidentale të mjeteve të pashpërthyer ushtarake në rajonin e Mitrovicës, që ndodhi në vitin 2000, ishte jashtë juridiksionit të përkohshëm të

Panelit. Duhet theksuar se ankesa ishte dorëzuar në Panel pas një aplikacioni që ishte dorëzuar nga ankuesi i njëjtë dhe që kishte të bënte me faktet e njëjta, i cili ishte shpallur i papranueshëm nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut më 2 maj 2007. Gjykata Evropiane e shpalli të papranueshëm aplikacionin, meqë ankesat ishin jokompatibile *ratione personae* me dispozitat e KEDNJ, që do të thotë se veprimet dhe mosveprimet të cilat paraqiteshin në ankesë nuk i atribuoheshin asnjë pale të Konventës.

Një numër i madh i rasteve që janë paraqitur pranë Panelit kanë të bëjnë me ankesat lidhur me shkatërrimin e pronës, kryesisht në kontekstin e konfliktit të armatosur në Kosovë në vitin 1999, dhe kërkesat e mëvonshme për kompensim, të dorëzuara në gjykatat komunale lidhur me dëmin e pronës. Në vendimin e papranueshëm të rastit *Lajović*, Paneli bëri me dije se juridiksioni i tij i përkohshëm është i kufizuar për shkeljet që janë bërë jo më herët se 23 prill 2005 apo që dalin nga faktet që u paraqitën para kësaj date, ku këto fakte shkaktojnë shkelje të vazhdueshme të të drejtave të njeriut. Sa i përket ankesës lidhur me dëmin e pronës të shkaktuar para 23 prillit 2005, Paneli konstatoi se nuk ka juridiksion. Mirëpo, Paneli konfirmoi juridiksionin e vet për uzurpimin e pohuar të vazhdueshëm të pronës që mund të përbënte një shkelje të vazhdueshme (*Lajović* 09/08.)

#### 6.1.2 *Pranueshmëria ratione personae*

22. Një numër i ankesave janë dorëzuar lidhur me aktet e kryera nga agjencitë të cilat nuk i atribuoheshin UNMIK-ut, siç është KFOR (Sahiti 03/08) dhe OSCE (Jovanović 39/08.), apo ndaj individëve privat (Nikolić 37/08), dhe kështu ishin jashtë juridiksionit të Panelit.

23. Ankesat u shpallën të papranueshme në raste të tjera meqë ankuesit nuk mund të konsideroheshin viktimat të shkeljeve të pohuara (*Teki Bokshi dhe të tjetër* 06/08).

#### 6.1.3 *Shterimi i të gjitha rrugëve në dispozicion për shqyrtim*

24. Në opinionin e vet për rastin *Canhasi*, në të cilin shqyrtoi një kundërshtim të vonshëm për pranueshmërinë e ankesës (Para 15 ante), Paneli caktoi një numër të parimeve themelore:

Paneli njoftoi se arsyeja e rregullës së mosshterimit është që autoriteteve kompetente t'u mundësojë, kryesisht gjykatave, mundësinë për të parandaluar apo rregulluar shkeljet e pohuara të instrumenteve relevante ndërkombëtare. Rregulla bazohet në supozimin e reflektuar në nenin 13 të KEDNJ dhe dispozitave të ngjashme të traktateve, se rendi vendor juridik do të sigurojë një mjet efektiv për shkeljet e të drejtave të ankuesit.

Paneli e bëri të qartë se nga ankuesit kërkohet vetëm të shterojnë mjetet vendore të cilat janë në dispozicion dhe janë efektive. “Mjetet e vetme të cilat kërkohen të shterohen janë ato që kanë të bëjnë me shkeljet e pohuara. Ekzistimi i mjeteve të tilla duhet të jetë mjaft i sigurt jo vetëm në aspektin teorik por edhe në praktikë, mungesa e të cilave do të shkaktojë mungesën e qasjes dhe efektivitetit të domosdoshëm (...). Mjetet diskrecionare ose të jashtëzakonshme nuk duhet të shterohen (...). Në përcaktimin nëse një mjet i caktuar i plotëson kriteret e disponueshmërisë dhe efektivitetit, duhet marrë parasysh rrethanat e veçanta të rastit individual (...).”

Paneli gjithashtu shpjegoi se barra e dëshmisë në rastet ku pala e paditur thirret në mosshkrimin e mjeteve i mbetet palës së paditur të vërtetojë se mjeti ishte efektiv, i cili ka qenë në dispozicion në aspektin teorik dhe praktik në kohën relevante. Pala e paditur duhet të demonstrojë se mjeti ka qenë i qasshëm, i aftë për të siguruar dëmshpërblim lidhur me ankesën e individit dhe se ka ofruar perspektivë të arsyeshme për sukses.

Lidhur me kundërshtimin e ngritur nga PSSP-ja për rastin *Canhasi*, ku ankuesi argumenton se nuk janë marrë masa adekuate për të hetuar në mënyrë të duhur vrasjen e gruas së tij, Paneli njoftoi se PSSP-ja kishte vërejtje se ankuesi nuk kishte kërkuar informacione të mëtejshme për hetimin nga Komisionari i Policisë së UNMIK-ut apo nga Ministria e Punëve të Brendshme. Paneli konkludoi se kërkesa për informacione të mëtejshme për përparimin e hetimeve, në këtë rast, nuk nënkuptonte/përbënte “rrugë në dispozicion për rishikim” të shkeljes së pohuar.

“Mjeti efektiv”i kërkuar nga ankuesi ishte “një hetim i hollësishëm dhe efektiv i cili do të mundësonte identifikimin dhe dënimin e atyre që janë përgjegjës për privimin nga jeta”, dhe jo thjeshtë informacione të cilat do të konfirmonin se hetimi i vrasjes kishte ngecur, me sa duket për tetë vjet (*Canhasi 04/08*).

25. Derisa kundërshtimi i palës së paditur në bazë të mosshkrimit të mjeteve nuk u mbështet në rastin *Canhasi*, një numër i ankesave pranë Panelit për të cilat u konstatua se janë të papranueshme si ankesa, ose kishin aplikacione në pritje për shqyrtim nga gjykatat ose nuk kishin përfituar nga e drejta për të parashtruar ankesë, dhe akoma nuk kishin shteruar të gjitha mjetet në dispozicion, apo ishin në pritje për procedurat e ndjekjes penale.

26. Ankesa për *Balaj dhe të tjerët* ngrit çështjen specifike të disponueshmërisë së një mjeti efektiv për dëmshpërblim në rastet ku përfshihet UNMIK-u në llogari të imunitetit të përgjithshëm të KB-së nga procedurat ligjore, në pajtim me Konventën mbi privilegjet dhe imunitetin e Kombeve të Bashkuara. Në këtë rast, Paneli i është bashkëngjitur çështjes së shterimit të mjeteve duke pasur parasysh bazueshmërinë e rasteve.

#### 6.1.4 Rregulla gjashtë-mujore

27. Në disa raste, ankesat nuk ishin paraqitur brenda periudhës relevante gjashtë-mujore, qoftë nga dita e shkeljes ose nga data kur është marrë një vendim i formës së prerë. Prandaj, Paneli siguroi udhëzime mbi shfrytëzimin e rregullës gjashtë-mujore. Paneli vendosi që, në rastin e procedurës pranë Komisionit të Ankesave të Çështjeve Banesore Pronësore, ku ankuesi kishte paraqitur kërkesë për rishqyrtimin e një ankese e cila është shpallur e papranueshme, data relevante e vendimit të formës së prerë të jetë data e vendimit të detyrueshëm dhe të zbatueshëm për kërkesën e tillë, (*Zrnzević 12/08, V.P. 05/08*).

#### 6.1.5 Ankesat e pabazuara

28. Një numër i ankesave u shpallën të papranueshme meqë shihej qartazi se ishin të pabazuara. Ky ishte pozicioni i Panelit ku ankesat nuk treguan ndonjë formë të shkeljes së të drejtave të njeriut (*Begolli 08/08, Teki Bokshi dhe Zeqir Bujupi 12/07, Nikolić 37/08*).

Në raste të tjera, Paneli njoftoi se ankuesi përpiquej, në të vërtetë, të ri-argumentoj rastin e tij, pasi që ishte shqyrtuar nga gjykata kompetente. Paneli ka vetëm juridiksion të kufizuar. Nuk mund të shqyrtojë rastin sikurse gjykata me kompetenca të plota për të gjitha aspektet e rastit. Kur ankuesi tregon për konstatimin e fakteve nga gjykata apo interpretimin e ligjit, Paneli është i kufizuar të vlerësojë nëse gjykata ka vepruar në mënyrë arbitrare ose të paarsyeshme. Nuk është detyrë e Panelit të veprojë si gjykatë e apelit ose gjykatë e "shkallës së katërt" nga vendimet e gjykatave të rëndomta, (*Emini 17/08, Bota Sot 02/06*).

## 6.2. Çështjet e bazuara

29. Paneli gjithashtu trajtoi një numër të çështjeve të bazuara, nga të cilat më i rëndësishmi është paraqitur më poshtë:

### 6.2.1 *E drejta për jetë (neni 2 KEDNJ)*

30. Siç u tha më lart, ankesa e *Canhasit* kishte të bënte me hetimet nga policia e UNMIK-ut për vrasjen e gruas së ankuesit, më 3 shkurt 2000, në Veri të Mitrovicës, nga persona të pidentifikuar, të cilët me dhunë hynë në banesën ku jetonin ankuesi me gruan e tij. Ankuesi pohon se hetimet e zbatuara nga UNMIK-u ishin joadekuate.

Në mendimin e vet, Paneli nënvizoi parimet relevante lidhur me aspektet procedurale për të drejtën për jetë të përfshira në nenin 2 të KEDNJ. Paneli theksoi, duke iu referuar praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut, se “neni 2 i KEDNJ, që mbron të drejtën për jetë, e radhit si një ndër dispozitat më fundamentale në KEDNJ dhe e konsideron si njërin prej vlerave themelore të shoqërive demokratike”. Prandaj, Paneli duhet të shqyrtojë pohimet për shkelje të kësaj dispozite me një “vështrim hetues” sa më të kujdesshëm të mundshëm.

Për më tepër, Paneli konstatoi se “obligimi për të mbrojtur të drejtën për jetë sipas nenit 2 të KEDNJ, e interpretuar në lidhje me detyrën e përgjithshme të shtetit sipas nenit 1 të KEDNJ për t’u ‘siguruar të gjithëve brenda juridiksionit të [vet] të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Konventë’, gjithashtu kërkon që të ketë ndonjë formë të hetimeve efektive zyrtare kur individët vriten si rezultat i përdorimit të forcës. (...)”.

U tha se shtrirja e obligimit procedural nuk është kufizuar për rastet e përfshirjes aktive të shtetit në një vrasje, por se ka një shtrirje më të gjerë autonome. Paneli citoi praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut: “Obligimi kërkon që të ketë ndonjë formë të hetimeve zyrtare efektive kur ka arsye për të besuar se një individ ka pësuar lëndime me rrezik për jetën në rrethana të dyshimta. Hetimet duhet të jenë në gjendje të konstatojnë shkaku e lëndimeve dhe identifikimin e atyre që janë përgjegjës me qëllim të dënimit të tyre. Kur për pasojë kemi vdekjen, si në rastin aktual, hetimeve duhet dhënë rëndësi edhe më të madhe, duke pasur parasysh faktin se qëllimi kryesor i hetimeve të tilla është të sigurohet implementim efektiv i ligjeve vendore, me të cilat mbrohet e drejta për jetë.”

Paneli pohoi se duhet ndërmarrë masa të caktuara hetimore për të siguruar hetime adekuate dhe efektive. “Me vendosmëri autoritetet është dashur të marrin hapat e arsyeshëm që i kanë pasur në dispozicion për të siguruar dëshmitë lidhur me incidentin, duke përfshirë, mes tjerash, dëshmitë e dëshmitarëve okularë (...) dhe dëshmitë nga dëshmitarët tjerë kryesor (...). Aty ku ka deklarata bindëse ose të besueshme, dëshmi ose informacione relevante për identifikimin, dhe eventualisht ndjekjen penale ose dënimin e kryerësit të vrasjes së paligjshme, autoritetet janë të



obliguara të ndërmarrin masa të tjera hetimore (...). Çdo mangësi në hetime që dëmton aftësinë e tij në përcaktimin e shkakut të vdekjes apo në identifikimin e personit apo personave përgjegjës, do të rrezikonte respektimin e këtij standardi (...).”

A Kërkesë tjetër është që hetimi të jetë i vazhdueshëm duke demonstruar përparim të vërtetë në zbatimin e hetimeve. Çdo periudhë e zgjatur e mosaktivitetit në një rast mund të jetë tregues i dështimit për të vazhduar hetimet në mënyrë efektive, me qëllim të identifikimit të kryerësve. Procedura hetimore gjithashtu duhet të sigurojë, në mënyrë të mjaftueshme, përfshirjen e viktimës, për aq sa është e nevojshme për të mbrojtur interesat e tyre legjitime.

Derisa është i “ndërgjegjshëm për nevojën që të mos interpretohet obligimi pozitiv për të hetuar në atë mënyrë e cila do të impononte një ngarkesë të pamundshme apo disproporcionale mbi autoritetet, duke pasur parasysh vështirësitë e punës së policisë në shoqëritë moderne, dhe i vetëdijshëm për zgjedhjet e vështira operacionale për sa i përket prioriteteve dhe burimeve”, Paneli konstatoi se duhet të jetë i kënaqur se autoritetet kanë bërë mjaft për të kryer obligimet e tyre në zbatimin e hetimit efektiv në këtë rast.

Zbatimi i këtyre parimeve në faktet e rastit *Canhasi*, Paneli konstatoi se kishte pasur një sërë të metash nga ana e UNMIK-ut lidhur me standardet e kërkuara për të qenë në harmoni me aspektin procedural të së drejtës për jetë. Derisa UNMIK-u kishte kryer disa analiza të mjekësisë ligjore, duke përfshirë edhe autopsinë e gruas së ankuesit, dhe kishte marrë deklaratat nga disa individë, nuk kishte indikacion se ishin marrë deklaratat nga të gjithë dëshmitarët relevant, duke përfshirë edhe dëshmitarët okularë. Edhe pse dëshmitarët i kishin dhënë UNMIK-ut emra dhe adresa të individëve të cilët ata pohonin të ishin të përfshirë në vrasjen e viktimës, nuk kishte dëshmi që të tregonte se ishin marrë deklaratat nga këta individë apo se ishin bërë përpjekje që të merreshin këto deklaratat.

Për më tepër, Paneli nuk kishte informacione në dispozicion për të demonstruar se ishin bërë përpjekje për vazhdimin e hetimeve për vrasjen gjatë kësaj periudhe prej tetë vjetësh nga shtatori 2000. Përfundimisht, ankuesi nuk ishte informuar për procesin hetimor, as nuk iu kishte ofruar ndonjë shpjegim pse nuk ishin marrë deklaratat nga personat për të cilët pohohe se ishin të përfshirë në krimin. Kështu, autoritetet kishin dështuar në kryerjen e një hetimi penal efektiv të rrethanave të vrasjes së znj. Canhasi, dhe kështu ishte bërë shkelje e nenit 2.

#### 6.2.2 E drejta për gjykim të drejtë (neni 6 § 1 KEDNJ)

31. Në ankesën e *Bota Sot*, nga Paneli, mes tjerash, kërkohej që të konstatojë nëse dështimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë për të treguar rrugët e mundshme të ankesës kundër aktgjykimit të vet përbënte shkelje të nenit 6 § 1 të së drejtës për gjykim të drejtë. Paneli konstatoi se “e drejta për gjykim të drejtë nuk mund të interpretohet përgjithësisht si imponim i obligimit ndaj shteteve që ata të sigurojnë që palët në kontest gjyqësor të informohen nga gjykata e shkallës së parë, për mundësitë e parashtrimit të ankesës kundër aktgjykimit të saj. Paneli nuk do ta përjashtonte mundësinë që një njoftim i tillë të kërkohej në rrethana të veçanta. Mirëpo, Paneli nuk sheh rrethana të tilla në këtë rast. Në këtë aspekt, duhet kushtuar rëndësi faktit se ankuesi ishte përfaqësuar nga një avokat” (*Bota Sot 02/06*).

32. E drejta për gjykim brenda një periudhe të arsyeshme ishte çështje në ankesën *Emini*. Në vendimin për pranueshmërinë e rastit, dhe në pritje të konstatimit të

bazueshmërisë së ankesës, Paneli njoftoi se kontestet e punësimit, për nga natyra e tyre, kërkojnë vendime të përshpejtuara, për shkak të interesit të personit në fjalë, i cili përmes pushimit nga puna, i humb mjetet e tij të jetesës (*Emini 17/08*).

### 6.2.3 E drejta në mbrojtje të pronës (neni 1 i Protokollit nr. 1)

33. Ankuesit në rastin e *Teki Bokshit dhe Zeqir Bujupit* pohuan shkeljen e të drejtës së tyre në pronë në bazë të tarifave të tyre profesionale ligjore joadekuate, të paguara nga gjykata në rastet e mbrojtjes së detyrueshme në procedurat penale. Paneli ka vërejtur se, “përderisa ankuesit e kundërshtojnë shumën e tarifës të cilën ata kanë të drejtë ta fitojnë, [...] neni 1 i Protokollit nr. 1 i KEDNJ zbatohet vetëm për gjërat ekzistuese të personit. Nuk garanton të drejtën për të fituar pasuri.

Si pasojë, një person i cili ankohet për një shkelje të së drejtës së tij në pronë, së pari duhet të tregojë se ka ekzistuar një e drejtë e tillë. Në këtë rast, Paneli konstaton se ankuesit, sipas rregulloreve në fuqi, nuk kanë treguar se kanë pasur ndonjë pritje legjitime se tarifat e tyre do të rriteshin. Ankuesit as nuk kanë vërtetuar se legjislacioni relevant u garantonte atyre të drejtën që të marrin pagesa për ndihmën e ofruar juridike në shuma më të larta, të cilat do të kualifikoheshin si ‘posedim’ në kuptim të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës” (*Teki Bokshi dhe Zeqir Bujupi 12/07*).

## 7. TË DHËNA STATISTIKORE

- Numri i rasteve të pranuar
- Numri i rasteve të vendosura
- Numri i rasteve në pritje për t’u vendosur

Statusi i rasteve	2006	2007	2008	Gjithsej
Numri i rasteve të pranuar	3	12	69	84
Numri i rasteve të vendosura	0	0	20	20
Numri i rasteve të cilat janë në pritje për t’u vendosur*	0	0	64	64

\* Nga gjashtëdhjetë e katër (64) rastet e përfshira në numrin e përgjithshëm lart, dhjetë (10) prej tyre janë konstatuar se janë të pranueshme dhe akoma nuk është marrë vendim për rezultatin e pesëdhjetë e katër (54) rasteve.

## 8. SHTOJCAT

SHTOJCA 1 – Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/12 e datës 23 mars 2006, për themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut

SHTOJCA 2 – Rregullorja e Punës së Panelit , miratuar më 5 shkurt 2008